



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT

Shërbimi: Mbrojtja e Mjedisit –Menaxhimi i mbeturinave

ANËTARËT E GRUPIT TË PUNËS

GRUPI I PUNËS		
#	Emri	Pozitat e punës
1	Gjokë Lleshaj	Koordinator i grupit – Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjente
2	Dardan Bashota	Anëtar i GP – Zyrtar për Mjedis
3	Milaim Musliu	Anëtar – KRM “Ambienti”
4	Elmi Krasniqi	Anëtar –Inspektor i Shërbimeve Publike
5	Silva Rashkoviç	Anëtar – Zyra për komunitete
6	Artan Prenaj	Anëtar – Shoqëria civile
7	Sllagjan Mikiq	Anëtar – përfaqësues i komunitetit
8	Lekë Bekaj	Anëtar - përfaqësues i komunitetit

Klinë 2015



DREJTORI SH.P.B
GJOKË LLESHAJ
Hoxha

I. ANALIZA E SITUATËS SË TANISHME

1.1 Informacion i Përgjithshëm për Komunën

Komuna e Klinës, gjendet ne rrafshin e Dukagjinit në anën perendimore të Kosovës rreth 60 km në perëndim të kryeqytetit të Kosovës.

Më foton 1. është paraqitur harta e shtrirjes territoriale të komunës se Klinës e siperfaqja e pergjithshme e komunës së Klinës është 309 km².




Foto.1. Shtrirja territoriale e komunës së Klinës

Klina në periudhën e më hershme njihet si vendbanim Ilir me emër Chinna, Komuna e Klinës, e themeluar ne vitin 1954 në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit në një hapsirë të pasur me pasuri natyrore.

Komuna e Klinës, me rrethinë ka rreth **38.496 banor**, në qytetin e Klinës jetojnë 5.908 banor ndërsa 32.588 jetojnë në zonat rurale.

Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë të volitshme për zhvillimin e bujqesisë si p.sh kultivimin e drithrave, pemëve dhe perimeve. Në fshatrat e komunës së Klinës bujqësia është veprimtaria kryesore. Komuna e Klinës përbëhet prej fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që shtrihen sipas zonave kadastrale.

Në Komunën e Klinë nga regjistrimi i fundit i bërë ne vitin 2013 jetojnë **38.496 banor**. Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelare strukturën e popullsisë e cila dominon në komunën e Klinës.

Zona	Nr.i banorëve	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptjan	Të tjerë	Të pa deklaruar	Nuk kanë qenë në dispozicion
Zona Urbane	5,908	2,892	3,016										
Zona Rurale	32,588	16,301	16,287										
Komuna e Klinës	38,496	19,193	19,303	37,216	98	3	20	78	85	934	23	7	32

Komuna e Klinës ka gjithsejt 54 vendbanime:

#	Vendbanimi	#	Vendbanimi	#	Vendbanimi
1	Klinë*	19	Leskoc	37	Ujmirë
2	Dolc*	20	Radulloç	38	□abiq
3	Dërsnik*	21	Berkovë*	39	Siqevë
4	Gremnik*	22	Drenoc*	40	Dobërdol
5	Zajm*	23	Grabanicë*	41	Gllarevë
6	Videjë*	24	Dugajevë	42	Rixhevë
7	Deiq	25	Pjetërq i Poshtëm*	43	Caravik
8	Krushevë e Vogël	26	Pjeterq i Epërm*	44	Zabërgjë
9	Gjurgjevik i Vogël	27	Bokshiq*	45	Sferkë
10	Klinafc*	28	Dollovë*	46	Dush
11	Jagodë*	29	Këpuz	47	Volljakë
12	Budisalc*	30	Qeskovë	48	Qypevë
13	Rudicë*	31	Jashanicë*	49	Përqevë
14	Krushevë e Madhe*	32	Pograxhë*	50	Shtupel*
15	Stupë*	33	Resnik*	51	Kërnice*
16	Nagllavë	34	Jelloç	52	Bingjë*
17	Zllakuqan	35	Dush	53	Gracp*
18	Ranoc	36	Gjurgjevik i Madh	54	Dranashiq*

*Vendbanimet në të cilat jeton komuniteti minoritar


Klina kufizohet me gjashtë komuna: Istog, Skenderaj, Malishevë, Rahovec, Gjakovë dhe Pejë. Nëpër qytetin e Klinës kalon edhe vija hekurudhore.

Resurset natyrore, komuna e Klinës është mjaftë e pasur me resurse natyrore duke përfshirë minerale dhe jominerale që është bazë e mirë për tërheqjen e investimeve. Ka një sasi të rezervave të linjtit, minerale të bosksitit, argjilë, rërë dhe zhavor.

Rezervat e linjtit dhe mineralet e bosksitit nuk janë në shfrytëzim për momentin, mirëpo në një të ardhme ato si një pasuri edhe mund të shfrytëzohen.

Në komunën e Klinës ka 6,109 familje, rreth 2,100 biznese dhe 61 institucione publike në menaxhim të administratës komunale.

Numri i institucioneve shkollore është 29 shkolla fillore dhe 2 shkolla të mesme, ndërsa numri i institucioneve komunale është 15, nga të cilat janë: objekti i administratës komunale, 10 Zyre të vendit dhe 4 institucione kulturore. Objekte shëndetësore në komunën e Klinës janë gjithsej 15, nga të cilat janë: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Klinë, 3 qendra të mjekësisë familjare në fshatrat Zllkakuqan, Ujmirë dhe Sferkë, si dhe 11 ambulanca (punte shëndetësore) në fshatrat: Budisalc, Jagodë, Drenoc, Grabanicë , Volljakë, Gllarevë, Caravik, Jashanicë, Jashanicë e Epërme, Shtupel dhe Leskoc.



1.2 Gjendja e Mjedisit

Për të pasur një jetë të shëndoshë është e rëndësishme të kemi edhe një mjedis të shëndoshë ngase çdo gjë në hapësirën ku jetojmë është e lidhur me mjedisin.

Ndotja e mjedisit paraqet një kërcënim të madh për popullsinë, gjendja e mjedisit në Komunën e Klinës nuk është në standarde mirëpo është më e mirë se në disa vendbanime të tjera në Republikën e Kosovës. Nga sfidat kryesore që ndikojnë që të kemi një jetë më të shëndoshë është kualiteti i ujit për pije, trajtimi i ujërave të zeza sipas standardeve (mungesa e impianteve për trajtim), huthja e pakontrolluar e mbeturinave - vendet ilegale të mbeturinave, nxierrja e rërës dhe zhavorit nga shtretërit e lumenjeve, humbja e tokës bujqësore, shtrirja e vendbanimeve në mënyrë të pakontrolluar.

1.3 Uji

Qyteti dhe një numër i vogël i fshatrave të Klinës furnizohen me ujë nga vendi i quajtur *Pusi i Jarniës*, mirëpo furnizimi i rregullt me ujë të pijes është në fazën finale të rregullimit ku është ndërtuar një fabrikë e re për furnizim me ujë e cila fabrikë furnizon qytetin dhe një numër të caktuar të fshatrave.

1.4 Ajri

Kualiteti i ajrit ndikohet nga lirimi i gazrave nga trafiku, djegia në hapsirë e mbeturinave atje ku ato nuk grumbullohen.

1.5. Lumenjtë

Klina është një territor që është i rrethuar nga 6 lumenj që kësaj komune ia shtojnë bukurinë. Këta lumenje janë: Lumi i Istogut, Lumbardhi i Pejës, Lumbardhi i Deçanit, Lumi Klina, Lumi Mirusha, Drini i Bardhë. Sot bukuria e këtyre lumenjeve është degraduar nga shfrytëzimi i pakontrolluar i zhavorit dhe nga huda e pakontrolluar e mbeturinave nga faktori njeri.

1.6. Shërbimi që është përzgjedhur për përmirësim - Prioriteti

Bazur në ligjet aktuale siç është Ligji për Mbeturinat miratuar në vitin 2012 dhe rregulloret tjera, prodhuesit e mbeturinave janë të obliguar që të jenë pjesë e sistemit dhe e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave të cilat janë nën përgjegjësinë e Komunës.

Zbatimi i sukseseshëm i ligjit dhe vënja në zbatim e një sistemi funksional për mbeturinat janë shumë të rëndësishme për Kosovën e veçanërisht për Komunën e Klinës. Vetëm kur të sigurohet se mbeturinat grumbullohen në tërë territorin e Komunës dhe deponohen-trajtohen si duhet atëherë mund të pakësohet rreziku për shëndetin e popullatës dhe krijohet një mjedis më i pastër për të gjithë.

Gjendja aktuale e ambientit në komunën e Klinës si dhe mbulueshmëria shumë e vogël e vendbanimeve të komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ka qenë vendimarrëse në përzgjedhje të këtij prioriteti-shërbimi për përmirësim.

Vënia në zbatim e një sistemi të mbledhjes së mbeturinave për tërë Komunën e Klinës nënkupton një qasje hap pas hapi, duke bërë zgjerim të planifikuar të ofrimit të shërbimit, bazuar edhe në kapacitetet e kompanisë por edhe duke organizuar një sistem të qëndrueshëm të grumbullimit të mbeturinave.

1.7. Gjendja e aktuale e shërbimit të zgjedhur për përmirësim

Problemi shqetësues për banorët lokal paraqet edhe çështja e mbeturinave të cilat hudhen vend e pavend. Nuk ekziston sistemi për reciklimin e mbeturinave të zakonshme, shtëpiake, industriale dhe materialeve të rrezikshme sidomos në fshatra. Kompania përkatësisht KRM "Ambienti" në Klinë bën grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.

Numri i ekonomive familjare që iu ofrohet shërbimi për grumbullim të mbeturinave është 3,134 apo 51.30%, kurse numri i vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është 12 apo 22.2 %.

Shërbimi ofrohet edhe për 42 institucione (shkolla, ambulanta, zyre vendi, policinë e Kosovës, postën, etj.) si dhe për 480 biznese.

Vlera vjetore e faturuar për ofrimin e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave është 183,442.81 € ndërsa vlera vjetore e inkasuar për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është 109,932.55 €, vlera e pagesave të bëra është 59.93%.




Foto.2. Deponi ilegale ne fshatin Volljak

Gjithashtu në komunën e Klinës ofrohet edhe shërbimi i larjes dhe pastrimit të një numri të caktuar të rrugëve i cili shërbim ofrohet bazuar në marrveshjen në mes të komunës dhe kompanisë KRM “AMBIENTI” – njësia në Klinë.

1.8. Mënyra e ofrimit të shërbimit

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Klinës ofrohet në zonën urbane dhe pjesërisht në pjesët rurale. Shërbimi bëhet me kontejner të përbashkët e pjesërisht derë me derë. Secili biznes dhe ekonomia familjare që është në shërbim ka kontratë me kompaninë që ofron shërbime të grumbullimit të mbeturinave.

Shërbimi ofrohet një herë në javë, ndërsa në disa pika në zonën urbane edhe më shpesh (aq sa ka nevojë), ndërsa qendër të qytetit çdo ditë.

Shërbimi ofrohet derë më derë, pos në tri vendbanime në të cilët shërbimi ofrohet përmes kontejnerëve të përbashkët (1.1 m³) (Grabanicë, Potërq dhe Gremnik).

Në zonën ku ofrohet shërbimi, mbeturinat e grumbulluara transportohen dhe deponohen në deponinë regjionale në Pejë.

Vendbanimet të cilave u ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave janë:

Nr	Emri i vendbanimit	Numri i familjeve	Numri i familjeve të cilat e marrin shërbimin	Mënyra e shërbimit dhe numri i kontejnerëve
1	Klinë		1988	Shërbimi kryhet në qendër në baza ditore, ndërsa në lagje 1 herë në javë, kemi 70 kontejner dhe pjesa tjetër me qese derë më derë.
2	Grabanicë	150	118	Shërbimi kryhet një herë në javë, me kontejner të shpërndarë. 40 kontejner 1.1 m ³
3	Potërq	100	114	Shërbimi kryhet një herë në javë, me kontejner të shpërndarë. 30 kontejner 1.1 m ³
4	Gremnik	150	100	Shërbimi kryhet një herë në javë, me kontejner të shpërndarë. 30 kontejner 1.1 m ³
5	Gllarevë	220	130	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
6	Rixhevë	115	70	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
7	Gjurgjevik i vogël	60	44	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
8	Zllakuqan	118	50	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
9	Dugajevë	70	35	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
10	Zajm	185	159	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
11	Dellovë	70	30	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës
12	Sferkë	296	296	Shërbimi kryhet një herë në javë, me qese të plastikës

Në vazhdim kemi paraqitur rrugët të cilat janë në programin e larjes dhe fshirjes:

Nr	Emri i rrugëve te cilat fshihen nga kompania
1	Skender Rexhepi
2	Hasan Prishtina
3	Imer Berisha
4	Ali Kelmendi
5	Dëshmorët e Kombit
6	Lidhja e Prizrenit
7	Abedin Rexha
8	Mehmet Haxha
9	Mirush Daka
10	28 Nëntori
11	Ganimete Tërbeshi
12	Mehdi Morina

Për t'i ofruar këto shërbime KRM "AMBIENTI" ka: 20 punëtorë, 4 kamion transportues mikser dhe 170 kontejnerë me vëllim 1.1 m^3 , të cilët janë të shpërndarë në teren (në Klinë 70, Poterq 30 dhe Grabanicë 40 dhe Gremnik 30) ku shumica nga ta janë të amortizuara.

Kompania, ka kapacitete që në mënyrë graduale të fillojë të zgjerojë zonën e shërbimit, por për shkak të inkasimit jo shumë të kënaqshëm ajo ka nevojë për përkrahje, posaçërisht në sigurimin e kontejnerëve familjarë (sepse kjo formë e shërbimit do të ndikojë në mënyrë direkte edhe në rritje të inkasimit) si dhe në rritje të inkasimit (përmes fushatave dhe formave tjera në përputhje me kornizën ligjore në fuqi). Por me rritjen e zgjerimit të shërbimit edhe kompania duhet të planifikojë kapacitete shtesë adekuate teknike e njerëzore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve konform standardeve.

1.9. Opinioni i qytetarëve për shërbimin e ndriçimit publik

Anëtarët e grupit punues të komunës së Klinës kanë pranuar se mendimet e qytetarëve janë të vlefshme për matjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve komunale. Përceptimet e qytetarëve mund të kombinohen me matjet e tjera sasiore për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të cilësisë, shtrirjes së shërbimit, prioritetëve dhe nevojave që ata kanë lidhur me këtë shërbim.

Në bazë të raportit të anketimit mbi kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet komunale respektivisht me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në vitet 2012 dhe 2013 është shprehur si vijon:

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave është përmirësuar dukshëm nga viti 2011 e deri më tani dhe atë:

- Është zgjeruar zona e shërbimit,
- Është rritë numri i familjeve dhe vendbanimeve të përfshira në shërbim dhe
- Është rritë kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimin

Më poshtë është tabela me rezultatet e të gjithë indikatorëve që tregojnë performancën e komunës së Klinës në ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Indikatorët	2011/2012	2012/2013	Trendi
% e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	41.76%	51.3%	↑
% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	18.52%	22.2%	↑
% e pagesave të bëra (Inkasimi)	61%	60%	↓
% e qytetarëve që pohojnë se grumbullimi i mbeturinave bëhet sipas orarit të përcaktuar	19%	46.5%	↑
% e qytetarëve të kënaqur ose deri diku të kënaqur me grumbullimin e mbeturinave	16%	42.5%	↑

1.10. Ide për përmirësimin e shërbimit

Grupi punues i komunës mendojnë se aktualisht mund të instalohet një shërbim më gjithë përfshirës duke menduar se këtij zinxhiri të ofrimit të shërbimeve ti shtohen edhe vendbanimet e pa përfshira në shërbim e cila drejt për drejt do të ndikonte në përmirësimin e kësaj fushe, përkatësisht mjedisit.

Në aspektin Institucional, disa ide të përgjithshme për përmirësimin e këtij shërbimi qëndrojnë në sa vijon me poshtë:

1. Zgjerimi i zonës së ofrimit të shërbimit
2. Eliminimi i deponive të egra
3. Pajisje me kontejner familjar
4. Fushatë informuese/vetëdijësuese për rëndësinë e shërbimit
5. Përmirësim i bashkëpunimit në mes të kompanisë dhe komunës
6. Ndërtimi i një pike transferi të mbeturinave të grumbulluara
7. Selektimi i mbeturinave dhe trajtimi i tyre (posaqërisht letra, plastika dhe metalet)

II. Misioni i dhe objektivat e komunës për shërbimin

2.1. Misioni i Komunës për Shërbimin e Mbledhjes së Mbeturinave

Komuna e Klinës do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit. Kurse në një afat sa më shkurtër, komuna e Klinës planifikon që shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të bëjë në formë më moderne respektivisht përmes mbledhjes së diferencuar për të inkurajuar riciklimin dhe reduktimi mbeturinave

2.2.Objektivat e Shërbimit te Grumbullimit te Mbeturinave

Grupi punues i ka përcaktuar dy objektiva:

1. Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimit.
2. Rritja e Mbulshmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.

Rezultatet e pritura nga realizimi/përmbushja e objektivit 1

- Rritja e kënaqshmërisë së qytetarve
- Ofrim i qëndrueshëm i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe rrespektimi i standardit të shërbimit
- Eliminimi i deponive ilegale/të egra

Rezultatet e pritura nga realizimi/përmbushja e Objektivit 2:

- rritja e numrit të familjeve që përfitojnë nga ky shërbim
- rritja e numrit të vendbanimeve/lagjeve të mbuluara me shërbim
- Qëndrueshmëri financiare e kompanisë– rritje e nivelit të inkasimit

Treguesit e mundshëm:

1. Numri ekonomive familjare (total, fshat, qytet) që kanë qasje në shërbim sipas të dhënave të ofruara nga Kompania
2. Numri i vendbanimeve që e marrin shërbimin nga Kompania
3. % e ekonomive familjare të cilat marrin shërbimin
4. % e vendbanimeve të përsfshira në shërbim
5. % e inkasimit nga ekonomite familjare, bizneset, institucionet
6. % e mbulimit të koston nga të ardhurat prej tarifave
7. Numri i kontejnerëve familjar
8. Numri i shportave të vendosura në hapësira publike/parqe/sheshe
9. Sasia vjetore e mbeturinave të grumbulluara në ton
10. Kosto njësi euro/ton mbeturina të cilat grumbullohen dhe largohen.

Përveç sa më sipër, komuna ka si objektiv:

- Rritjen e nivelit të pastërtisë së hapësirave publike
- Mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese në qendrën urbane
- Pastrimin e trotuareve dhe rrugëve në qendrën urbane
- Vetëdijesimin e qytetareve rreth menaxhimit të mirëfilltë të mbeturinave

- vetëdijesimin mbi pagesën e faturave për shërbimin e ofruar, etj.

III. REZULTATET DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Grupi punues pas analizës së bërë për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në komunën e Klinës, si dhe bazuar në kapacitetet humane, teknike e financiare ka përcaktuar edhe rezultatet për vitet në vazhdim. Gjithashtu janë përcaktuar indikatorët të cilët duhet të arrihen me qëllim të realizimit të rezultateve të përcaktuara, si më poshtë:

3.1. Rezultatet dhe Indikatorët e Synuar të Shërbimit

Rezultatet e Dëshiruara	#	Indikatorët e Rezultateve	Viti bazë 2013/2014	Synimi viti 2015	Synimi viti 2016	Burimi Info
Rritja e kënaqshmërisë së qytetarëve me cilësinë e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	1	% e qytetarëve që janë të kënaqur, apo shumë të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	42.5%	50%	60%	Anketa
	2	% e qytetarëve të cilët deklarojnë se grumbullimi i mbeturinavë bëhet në orarin e caktuar	46.5%	51%	63%	Anketa
Mbulueshmëria e territorit të komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	1	% e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	51%	65%	100%	DSHPE
	2	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	22.2%	33.3%	100%	DSHPE
Rritja e inkasimit për shërbimin e ofruar	1	% e mbledhjes së tarifës	60 %	63%	70%	Kompania

3.2. Indikatorët të tjerë

Rezultatet e pritshme	Indikatorët e Rezultatit	Baza	Viti Objektiv 2015	Viti Objektiv 2016	Burimi i informacionit
<i>Burimet</i>					
	Makineri	3 kamion	4 kamion	5 kamion	Kompania
	Punëtor	19 punëtor	20 puntor	25	Kompania
	Kontejnerë 1.1 m ³ - të vendosur në tri fshatra dhe në disa pjesë të qytetit, institucione dhe biznese të mëdha	170 copë	170 copë		DSHPE dhe Kompania
	Shporta rrugore	50 copë	75 cope	100 copë	DSHPE
	Kontejner familjar	0	700 copë	1,500 copë	DSHPE, Kompania dhe donatorë
<i>Produkti</i>					
	Nr. i qytetarëve të anketuar	200	200	200	Anketa
	Nr. i ekonomive familjare	6,109	6,109	6,109	DSHPE
	Nr. i ekonomive familjare që marrin shërbim	3,134	3,970	6,109	Kompania
	Nr. i ekonomive familjare në qytet që marrin shërbim	1,988	2,324	x,xxx	Kompania
	Nr. i ekonomive familjare në fshat që marrin shërbim	1,146	1,646	x,xxx	Kompania
	Nr. i vendbanimeve në komunë	54	54	54	DSHPE
	Nr. i lagjeve në qytet	1	1	1	DSHPE
	Nr. i vendbanimeve - fshatra	53	53	53	DSHPE
	Nr. i vendbanimeve që marrin shërbim	12	15	54	Kompania
	Nr. i vendbanimeve në qytet që marrin shërbim	1	1	1	Kompania
	Nr. i vendbanimeve në fshat që marrin shërbim	11	17	53	Kompania

IV. PLANI I VEPRIMEVE

SIAP për Përmirësimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave në Komunën e Klinës synon të arrijë rezultatet dhe produktin, realizimi i të cilave do të sjellin arritjen e objektivave të synuar nga ky Plan.

4.1. Synimi e Rezultateve të Propozuara për vitin 2015

Zbatimi i SIAP në Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave synon që gjatë vitit 2015 të arrijë rezultatet si më poshtë:

- 1. Përmirësimi i shërbimit do të bëjë të mundur që rreth 50 % e qytetarëve që deklarojnë se janë shumë të kënaqur apo deri diku të kënaqur me shërbimin, pra pritet të ketë rritje prej rreth 7.5% kundrejt 42.5 % që është vlerësuar në vitin 2013. Matja e treguesit për këtë rezultat do të realizohet nëpërmjet anketës së qytetarëve.*
- 2. Komuna do të synojë të rrisë zonën e mbulimit me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në komunën e Klinës. Treguesit e këtij rezultati në vitin 2015 do të synojnë nivelet e 33.3% në vitin 2015 kundrejt 22.2% në vitin 2014.*
- 3. Do të shtohet numri i familjeve të cilat do ta marrin shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Treguesi i këtij rezultati në vitin 2015 pritet të arrijë nivelin 65% kundrejt 51% në vitin 2014.*

4.2. Plani i Veprimt për Zbatimin e SIAP

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shkurtimisht plani i veprimt, i cili përfshin objektivat, veprimet prioritare, afatet kohore, përgjegjësitë dhe buxhetet e përafërta për arrijjen e objektivave, rezultateve të përcaktuara:

Hapat e Veprimt	Si	Kush	Kur	Kosto
Aprovimi i SIAP	Lidhja e SIAP me buxhetin, Aprovimi i SIAP nga Kuvendi i Komunës	Grupi Punues, Kryetari dhe Kuvendi	Qershor 2015	Pa kosto
Aplikimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave derë më derë/ Kontejner Familjare	Identifikimi i zonave (5 fshatrave) Hartimi i Projektit Sigurimi i Buxhetit – blerja e 700 kontejnerëve familjar Hartimi i Planit të shpërndarjes së kontejnerëve dhe planit/orarit të grumbullimit në fshatrat: Dersnik, Gremnik, Videjë, Krushëvë E Madhe dhe Berkovë.	Komuna Kompania Donatori	Qershor – Korrik 2015	45.000 Euro
Shtrirja e shërbimit në vendbanime të reja (rurale)	- Aplikimi i sistemit derë më derë përmes përdorimit të kontejnerëve familjarë dhe të përbashkët – për 700 familje në vitin 2015 ndërsa për 1,500 familje në vitin 2016, - Aplikimi i sistemit derë më derë me kесе plastike për 136 familje në vitin 2015 ndërsa në vitin 2016 në të gjitha familjet tjera - shtimi i shportave për mbeturina në rrugët kryesore dhe në parqe/sheshe	Kompania Komuna Donatori	Korrik 2015 - 2016	40,000 euro
Ngritja e vetëdijes së qytetarëve	Informimi përmes Radios Lokale dhe mediave tjera lokale; Dizenjimim prodhimi dhe shpërndarja e informacionit të shkruar për ndërgjegjësim;	DSHPE, Inspektorët e ambientit, kompania	Korrik – Gusht 2015	500 euro

Organizimi i Aksioneve për pasttrimin e ambientit	Takime dhe Ligjeratnëpër shkolla Takimi, planifikimi dhe kordinimi i aktivitetit me shkollat fillore dhe të mesme Takimi dhe planifikimi e kordinimi i aktiviteve me kompanitë private dhe publike	DSHPE Drejtoria e Arsimit Drejtoria Inspektoratit Kompania	Gusht-Shtator 2015	1,000 Euro
Implementimi/harmoni zimi Rregullores për mbrojtjen e Ambientit dhe Ligjit në Fuqi	Hartimi dhe zbatim i planit të inspektimit për zbatimin e rregullores	Administrata komunale Kompania	Tetor 2015	
Monitorimi i Rezultateve dhe raportimi i qytetarëve	Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të SIAP-it; Monitorimi dhe raportimi i shpenzimeve; Monitorimi dhe raportimi i rezultateve të vlerësuara përmes anketimit	Institucionet komunale, Shoqeria Civile-OIQ-të, etj.	Në kontinuitet	
Marja e opinionit qytetar për shërbimin	Pregatitja e pyetësorit, Anketimi qytetarëve Përgatitja e raportit dhe publikimi (anketimet mund të bëhen para fillimit të ofrimit të shërbimit si dhe 3 muaj pas fillimit të ofrimit të shërbimit)	DSHPE Shoqeria Civile Grupi Punues-SIAP	Shtatorë 2015	1,500 Euro
Përgatitja e Planit për mbledhjen e diferencuar të mbeturinave	Përcaktimi i një Zone Pilot për grumbullimin e selektuar të plehrave dhe analiza e fizibilitetit.	DSHPE dhe Grupi Punues i SIAP-it Donatorë	Shtator 2016	
Eliminimi i Deponive të Egra në komunën e Klinës	Identifikimi i deponive të egra; Vlerësimi i sasisë dhe kostove për eliminimin e tyre; Plani i largimi/eliminimit të deponive të egra.	Kompania Komuna	Mars-Prill 2016	15.000 Euro
Rishikimi i implementimit të planit	Rishikimi i implementimit të planit Planifikimi dhe modifikimi i aktiviteve të planit për vitet 2016-2018	Grupi punues, DSHPE	Shtator dhe Dhjetor 2015	

V. STRATEGJIA PËR KOMUNIKIMIN ME PUBLIKUN

Komuna e Klinësmendon ta zhvillojë këtë komponent të Planit në dy drejtime:

1. Marrja e opinionit qytetar për shërbimin e pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave nëpërmjet përdorimit dhe përpunimit e të dhënave të anketës së qytetarëve.
Anketa nga ana e MAPL-së do të zhvillohet në muajin shtator/tetor të vitit 2015. Mirëpo preferohet që në çdo zonë ku shtohet shërbimi të bëhet një anketë për ato zona. Të dhënat do të shërbejnë për të përcaktuar treguesit dhe rishikuar planin në funksion të arritjes së objektivave.
2. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për një komunëmë të pastër.
Në këtë kuadër komuna në bashkëpunim me Kompaninë do të angazhohen në përgatitjen e materialeve dhe publikimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese për qytetarët, veçanërisht në vendbanimet rurale me qëllim ndërgjegjësimin për mbajtjen e mjedisit të pastër dhe sensibilizimin për pagesën e tarifës së pastrimit.
3. Mbledhja e të dhënave të vazhdueshme mbi numrin e ankesave

5.1. Plani për mbledhjen e të dhënave

Mjetet e informimit/Burimi i të dhënave	Hapat e mbledhjes së të dhënave / informimit	Përgjegjësia	Afatet Kohore
Pergatitja dhe shpërndarja e informacionit të shkruar për ndërgjegjësim	Hartimi i planit dhe përcaktimi i mjeteve të informimit dhe komunikimit	Grupi Punues për SIAP, DEMI	Qershor-Korrik 2015
	Pergatitja, shtypja dhe shpërndarja informacionit të shkruar informative	DSHPE, Zyra Informimit, Kompania	Gusht – Shtator 2015
Anketimi i qytetarëve	Hartimi i pyetsorit, planifikimi dhe realizimi i anketës Përpunimi, vlerësimi i opinionit qytetar dhe publikimi i rezultateve	Grupi Punues për SIAP,	Nëntor 2015
Mbledhja e të dhënave për indikatorët bazë	Mbledhja e të dhënave mbi ankesat e qytetarëve për shërbimin e pastrimit si dhe të dhëna të tjera të cilat konsistojnë në indikatorët kryesor	DSHPE	Periodikisht Raportimi çdo 6 muaj

VI. PLANI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

6.1. Plani i Monitorimit dhe i raportimit të SIAP-it, Klinë

1. Pas aprovimit të Planit Grupi Punues i SIAP do të mbledhet çdo muaj duke filluar nga aprovimi prej Kuvendit për të monitoruar progresin e realizimit të Planit të Veprimit, Mbledhjes së të dhënave dhe ecurinë e aktiviteteve fizike në teren.
2. Hartimi i Planit dinamik dhe monitorimi i rregullt i projektit në teren nga Grupi Punues i SIAP lidhur me shpërndarjen e kontejnereve (se paku dy herë në muaj).
3. Hulumtimi i opinionit të qytetarëve përmes anketimit lidhur me kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimin e ofruar.
4. Informimi i qytetarëve lidhur me ofrimin e shërbimit (përmes webfaqes komunale, radiove lokale, broshurave, etj.)
5. Raportimi i rregullt i Grupit Punues të SIAP-it te kryetari, te Kuvendi Komunal - çdo 6 muaj (apo edhe sipas nevojës)

6.2. Raport mbi Performancën (Realizimin e Rezultateve) Faktik dhe atë të Synuar

#	Indikatorët e Rezultatit	Vlera Bazë 2014	Synimi Viti 2015	Fakti 2015	Përmirësime ose Ndryshime	Synimi 2016
1	% e qytetarëve që janë të kënaqur, apo shumë të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	42.5%	50%			60%
2	% e qytetarëve të cilët deklarojnë se grumbullimi i mbeturinave bëhet në orarin e caktuar	46.5%	51%			63%
3	% e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	51%	65%			100%
4	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	22.2%	33.3%			100%
5	% e mbledhjes së tarifës	60 %	63%			70%